

**KARTELË INFORMATIVE**

AL042030

<b>1. Emri i shërbimit</b>	<i>Leje shfrytëzimi (minerare)</i>
<b>2. Cili është qëllimi i shërbimit?</b>	<i>I jep të drejtën për të ushtruar aktivitetin në fushën e minerareve</i>
<b>3. Çfarë ofron ky shërbim?</b>	<i>Ky shërbim i jep të drejtën qytetarit për të rregulluar aktivitetin që ushtron, në fushën e minerareve</i>

**4. A jam përfitues?** *Subjekte tregtare që shfrytëzojnë minierat*

Nr	Lloji	Nga lëshohet?	Vlefshmëria
<b>Dokumentet Shoqëruese për subjektet tregtare:</b>			
1	Dokument identifikimi	Aplikanti	
2	Nëse personi që paraqitet në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) nuk është përfaqësuesi ligjor, nevojitet: a. Prokurë noteriale për personat fizikë; b. Autorizim nga subjekti për personat juridikë	Aplikanti / Noteri	
<b>Dokumente provuese:</b>			
1	Një përshkrim të kapaciteteve teknike, profesionale dhe menaxheriale të kërkuesit që kanë lidhje me veprimtarinë e shfrytëzimit ose kërkim-zbulim-shfrytëzimit. Përshkrim e përvojës së tij të mëparshme në fushën e industrisë minerare nëse ka. Curriculum Vitae të stafit të tij që do të punojë për këtë veprimtari.	Aplikanti	
2	Kontratën e noterizuar me drejtuesin teknik të punimeve, i cili duhet të jetë inxhinier i fushës së aktiviteteve minerare të shfrytëzimit sipas emërtimeve të universiteteve vërtetuar me diplomën përkatëse	Noteri/Aplikanti	
3	Projektin e zhvillimit të aktiviteteve minerare të shfrytëzimit ose kërkim zbulim-shfrytëzimit dhe programin e investimeve për shfrytëzimin, sipas formatit të specifikuar në VKM-në nr. 942, dt. 17/11/2010.	Grup ekspertësh të certifikuar	
4	Kërkesën për akt-verifikimi sipas aneksit 3 të VKM -së 942 datë 17.11.2010	Aplikanti	

5. Çfarë dokumentesh duhen për aplikim?	5	<i>Një plan pune investimi të propozuar për t'u kryer, që përfshin një plan pune, afatet së bashku me shpenzimet e parashikuara për këtë program investimi që duhet të vlerësohet nga strukturat përgjegjëse dhe miratohet nga ministri. Vlera e garancisë së investimit duhet të vlerësohet nga strukturat përgjegjëse dhe të miratohet nga ministri</i>	<i>Aplikanti</i>	
	6	<i>Projektin e rehabilitimit të zonës minerare i cili përfshin: i. projektin e veprimtarive të mbylljes; ii. projektin e menaxhimit të mbetjeve minerare; iii. projektin e rehabilitimit progresiv dhe përfundimtar të zonës minerare</i>	<i>Aplikanti + Ekspertët</i>	
	7	<i>Përcaktimet për vlerat e garancive financiare për realizimin e programit të investimit dhe realizimin e planit të rehabilitimit të zonës minerare</i>	<i>Aplikanti</i>	
	8	<i>Burimet financiare të nevojshme për realizimin e investimeve të programuara për të zhvilluar veprimtarinë minerare të shfrytëzimit ose kërkim-zbulim-shfrytëzimit dhe një nga vërtetime për ekzistencën e tyre si më poshtë:  i. Një deklaratë nga banka që të konfirmojë se personi juridik ka çelur numrin e llogarisë, ku duhet të ketë të depozituara të paktën 20 % të vlerës së investimit të parashikuar në programin e investimeve që ka paraqitur  ii. Një dokument që vërteton se personi juridik ka siguruar një kredi prej një banke ose subjekti tjetër financiar, me vlerë e cila mbulon investimet e parashikuara për t'u kryer</i>	<i>Aplikanti + Banka</i>	

		iii. Një kontratë me një investitor, i cili garanton mbështetje financiare për realizimin e programit të investimit. Në këtë rast personi juridik duhet të paraqesë një dokument noterial, në të cilin shprehet vullneti i investitorit për të mbështetur këtë investim, si dhe dokumentet që provojnë burimet financiare të këtij të fundit (garanci bankare ose bilancet ekonomike të shoqërisë, në të cilën investitori është pronar/aksionar i vetëm, ose aksionar i shumicës së zotërimit të aksioneve/ kryesor maxhoritar)		
	9	Deklarim me shkrim burimin ligjor të gjithë informacionit gjeologjik apo gjeologo - minerar, të përdorur në ndërtimin e dokumentacionit aplikues.	Aplikanti	
	10	Mandatpagesa	Banka	
6. Ku mund të aplikoj?	<b>Zyrat pritëse</b>	<b>Qyteti</b>	<b>Adresa e sporteleve</b>	<b>Orari</b>
	Sporteli i shërbimit të Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB)	Tiranë	Bulevardi Zhan D'Ark (ish-Hoteli i Oficerave), pranë Ministrisë së Jashtme	Nga e hëna deri të enjten, ora 9.00 – 14.00; të premten, ora 9.00 – 13.00
7. A është ky shërbim online?	<b>Niveli 1</b>	<b>Niveli 2</b>	<b>Niveli 3</b>	<b>Niveli 4</b>
	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
8. Sa është tarifa për marrjen e shërbimit?	<b>Tarifa bazë</b>	<b>Tarifa shtesë</b>	<b>Mënyra e pagesës</b>	
	100 lekë	Tarifa sektoriale Komisionet bankare eventuale	Me para në dorë te sporteli/arka e institucionit; Sporteli i një banke brenda institucionit; Sporteli i një banke jashtë institucionit	
9. Sa kohë nevojitet për të marrë shërbimin?	124 ditë			
10. Çfarë përfitoj?	Leje shfrytëzimi (minerare)			
11. Ç'afat vlefshmërie ka?	25 vjet në rastin e lejeve të shfrytëzimit për mineralet metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet; 1 vit në rastin e lejeve të shfrytëzimit për mineralet ndërtimore 3 vjet në rastin e lejeve të shfrytëzimit të karrierve për qëllime publike vendore			
12. Ku e marr?	Në sportele <input checked="" type="checkbox"/>	Me postë <input type="checkbox"/>	Me internet <input checked="" type="checkbox"/>	Me e-mail <input checked="" type="checkbox"/>
13. Cili është institucioni përgjegjës?	Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB)			
14. Ku mund të gjej informacion për këtë shërbim?	<b>Kontaktto në:</b>		<b>Oraret e hapura</b>	
	Tel: 11800 e-mail: Informacion@adisa.gov.al		E hënë - E premte ora 07:00 - 21:00 E shtunë ora 07:00 - 14:00	
15. Nëse kam ankesë, si të veproj?	Në sportele <input checked="" type="checkbox"/>	Me postë <input type="checkbox"/>	Me internet <input type="checkbox"/>	Me e-mail <input type="checkbox"/>
16. Cila është baza ligjore e këtij shërbimi?	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ligji Nr. 10081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë"</li> <li>VKM Nr. 538, datë 26.05.2009 "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga ose nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta", e ndryshuar</li> <li>Ligjit Nr. 10304, datë 15.07.2010 "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë"</li> <li>VKM Nr. 942, datë 17/11/2010, "Për miratimin e procedurave dhe të dokumentacionit për marrjen e lejeve minerare në zonat e hapura"</li> </ul>			

